

UDHËZIM
Nr. 7, datë 26.4.2019

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2019,
SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, për vitin shkollor 2018–2019, do të zhvillohen si më poshtë:

- a) Gjuhë e huaj: 20 gusht 2019 ,
- b) Gjuha shqipe: 23 gusht 2019 ,
- c) Matematikë: 28 gusht 2019.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën “Gjuhë amtare”. Provimi kombëtar i arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën “Gjuhë amtare”, do të zhvillohet më 19 gusht 2019.

3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 774, datë 22.11.2018, “Për miratimin e rregullores për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019”.

4. Provimet kombëtare të arsimit bazë 2019, sesioni i dytë, fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

5. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019”.

6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën “Gjuhë amtare”, sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë. Në ditën e provimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Delvinë dhe Sarandë, tërheqin tezën në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë.

7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën “Gjuhë amtare”, sesioni i dytë, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë.

8. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

9. Arkivimi i testeve bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

10. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, sesioni i dytë, dhe raporton në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini